REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

# V E N D I M
## PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATAVE TË KLUBEVE SPORTIVE PËRFITUESE TË SUBVENCIONEVE PËR VITIN 2024

### Neni 1

Me këtë Vendim, **Bekim Zaskoku**, Zyrtar në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtar përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratave të klubeve sportive përfituese të subvencioneve për vitin 2024.

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontrateve të klubeve sportive si vijon :

| Nr. | Emërtimi i OJQ-ve (Klubeve Sportive) |
|---|---|
| 1. | K.F "Ulpiana 1926" - Lipjan |
| 2. | K.F "Arbëria" - Dobrajë e Madhe |
| 3. | K.F "Ulpiana 1992" - Lipjan |
| 4. | K.V "Ulpiana" meshkujt - Lipjan |
| 5. | K.V "Ulpiana" femrat - Lipjan |
| 6. | K.V "Skenderbeu" |
| 7. | K.SH "CED ELITA" |
| 8. | K.B "Lipjani" |
| 9. | SH.F " ATLETIKO B" |
| 10. | K.F "Veteranët" |
| 11. | SH.F "Minatori" |
| 12. | K.H "Ulpiana" meshkujt |
| 13. | SH.P '' Sportit Shkollor'' |
| 14. | K.P "Ulpiana'' |
| 15. | K.H "Ulpiana" Femrat |
| 16. | K.P.B.O "PAK Blinaja" |
| 17. | K.P.P "PAK Lipjani" |

**Neni 2**

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontratave të klubeve të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtari përgjegjës Bekim Zaskoku dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-36066
Lipjan, më 26.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, nenit 23 të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

# V E N D I M
## PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË KONTRATËS TË OJQ-SË PËRFITUESE PËR AKTIVITETET E KULTURËS DHE SPORTIT DUKE PËRFSHIRË ORGANIZIMIN E FESTIVALIT "MËRGATA FEST AND SPORTS 2024" LIPJAN

**Neni 1**

Me këtë Vendim, **Pranvera Krasniqi**, Zyrtare në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** Zyrtare përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të kontrates të lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe OJQ-së "Vizioni Rinor i Shalës" për realizimin e projektit për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest and sports 2024".

Zyrtari përgjegjës do të bëjë monitorimin e zbatimit të kontrates të OJQ-së si vijon :

| Nr. | Emërtimi i OJQ-së |
|---|---|
| 1. | OJQ-ja "Vizioni Rinor i Shalës" |

**Neni 2**

Zyrtari përgjegjës është i obliguar të bëjë monitorimin e zbatimit të Kontrates të lidhur mes Komunës dhe OJQ-së të cekura konform dispozitave të Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

**Neni 3**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Zyrtarja përgjegjës Pranvera Krasniqi dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

1Nr. 112/02-36069
Lipjan, më 26.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 60 paragrafi 3 dhe 85 të Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik , Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr 21 e datës 16.09.2023 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës, merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT DISIPLINOR PËR STAFIN ARSIMOR

I. Me këtë Vendim, **themelohet** Komisioni disiplinor për stafin arsimor , në këtë përbërje:

1. Liridon Duhlaku , Kryesues i Komisionit
2. Rizvan Hoxha, anëtar i Komisionit
3. Mexhide Gashi, anëtare e Komisionit

II. Komisioni disiplinor do ti shqyrtoj lëndët të cilat i adresohen sipas kompetencës për shkelejet e supozuara disiplinore të stafit arsimor në pajtim me procedurat disiplinore të përcaktuara me dispozitat e Ligjit nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe dispozitave tjera ligjore që e rregullojnë këtë çështje.

III. Mandati Komisionit është dy (2) vjeqar.

IV. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me kopje të Vendimit njoftohen

Drejtori I DKA-së – Lipjan
Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit

1Nr. 020/04-32088
Lipjan, më 05.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008 si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKTIT TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL TË KOMUNËS PËR PERIUDHËN 2024-2029

**Neni 1**
**Përbërja**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për hartimin e Projektit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës për periudhën 2024-2029 ( në vazhdim të tekstit Komisioni), në përbërje si vijon:

1. Diamant Bytyqi , Nënkryetar i Komunës , Kryesues I grupit punues
2. Valon Pacolli, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim, zëvendëskryesues
3. Shkëlzen Hajdini, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
4. Elmaze Behluli, Drejtorati i Administratës , anëtar
5. Sead Aliu, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar
6. Latif Ramadani, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
7. Anila Reqica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport
8. Rexhep Rexhepi, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, anëtar
9. Burim Rrustemi, Drejtorati për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim
10. Islam Kaleshi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore
11. Linda Shahini, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
12. Fitore Buja, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtare
13. Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtare
14. Jetmir Bytyqi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
15. Armend Duriqi, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër, anëtar
16. Bukurie Zejnullahu, Zyrtare për konsultim me publikun , Zyra për Informim, anëtare
17. Fadil Sopa, nga komuniteti i biznesit, anëtar
18. Leotrim Pajaziti, nga Shoqëria Civile, anëtar
19. Bafti Dogani, i propozuar nga MAPL në cilësi të konsulentit)

**Neni 2**
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit është që të hartojë Projektin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal të Komunës për periudhën 2024-2029 më së largu me date 10.09.2024.

Pas përfundimit të Projektit të cekur, Komisioni është i obliguar të përgadisë Raport me shkrim për Kryetarin e Komunës për mbarëvajtjen e këtij procesi. Raportit i bashkëngjitet Projekti i Stategjisë i cili pastaj do të vëhet në shqyrtim publik dhe pas përfundimit të shqyrtimit publik ky dokument përfundimisht dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

**Neni 3**
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.

1Nr. 020/04-33502
Lipjan, më 12.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar me / Primljeno: 12.07.2024 | | |
|---|---|---|
| Njesia / Jednica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 01-020/04-33501 | | |

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës, nenit 25 të Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunës nxjerr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

**Neni 1**

Me këtë Vendim, formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave të stafit shëndetësor për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-23064 i datës 13.05.2024, në këtë përbërje:

1. Izer Sinani, QKMF-Lipjan, Kryesues
2. Islam Kaleshi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
3. Besa Bislimi, Sektori për personel, anëtare

**Neni 2**

1. Detyrë e Komisionit të ankesave është shqyrtimi i ankesave për procesin e konkursit publik të shpallur nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale QKMF – Dr. Mehdi Zejnullahu – Lipjan Nr.03.111/01-23064 i datës 13.05.2024 dhe ka mandat të përkohshëm përkatësisht vlen vetëm për procedurat e konkursit të cekur.
2. Komisioni shqyrton ankesën dhe publikon rerezultatin përfundimtar brenda 5 (pesë) ditëve dhe për secilën ankesë nxjerr vendim në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR.01/2024 për rregullimin e procoedurave të konkursit në sektorin publik si dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit.
Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave 1Nr.020/01-15963 i datës 22.03.2024.

1Nr. 020/04-33501
Lipjan, më 12.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021 i datës, Kryetari i Komunës merr

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

**Neni 1**
**Përbërja**

Formohet Komisioni për testimin e shpenzimeve të veturave zyrtare në këtë përbërje:

1. Behar Mjeku , Kryesues,
2. Shefki Sadiku, anëtar,
3. Naman Limani, anëtar

**Neni 2**
**Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit**

Detyrë e Komisionit është vërtetimi - testimi i saktë i shpenzimeve të të gjitha veturave zyrtare të Komunës.
Pas vërtetimit - testimit të saktë të shpenzimeve të të gjitha veturave zyrtare të Komunës, Komisioni duhet të përgadisë raport me shkrim të cilin duhet tia dorëzojë Kryetarit të Komunës dhe një kopje për Drejtoreshën e Drejtoratit për Administratë .

**Neni 3**
**Hyrja në fuqi**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtori i Drejtoratit për Administratë, Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 020/04-31560
Lipjan, më 03.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.04/2023 për Administratë të hapur në Komuna, si dhe Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr.15-353-35739, e datës 30.06.2021, Kryetari i Komunës nxjerr:

# VENDIM

## MBI KONSULTIMIN E PUBLIKUT PËR DRAFT – PLANI I ORAREVE TË RENDEVE TË UDHËTIMIT PËR LINJAT E TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT 2024-2028

### Neni 1

Për të realizuar konsultimet dhe pjesëmarrjen e publikut, në miratimin e akteve nga kompetenca e Komunës, të publikohet në WebFaqen e Komunës:

Draft – Plani i i orareve të rendeve të udhëtimit për linjat e transportit të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit 2024-2028.

### Neni 2

Vërejtjet dhe sugjerimet në këtë Draft- Plan mund ti dërgohen Drejtoratit për Shërbime, Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ose në email adresën burim.rrustemi@rks-gov.net, më së largu me datë 18.07.2024.

### Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

1Nr.345/01-31690
Lipjan, më 03.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Na osnovu članova 13, 58 i 68 stav 68.4 Zakona o Lokalnoj Samoupravi Br.03/L-040,Službena Novina Republike Kosova, br.28 dt. 4 juni 2008, članova 40, 41 i 67 Statuta Opštine Lipljan 15Br.110-78095 dt. 24.12.2021, Administrativno Upustva (MUP) Br.04/2023 za u pravu open u open u opštini, Uredba o Transparentnosti u Opštini Lipljan, Br. 15-353-35739 dt.30.06.2021, Predsednik Opštine donosi:

ODLUKA
O JAVNOJ KONSULTACIJI ZA PROJEKT- AKCION PLAN I RASPORED POLAZAKA LINIJA PUTNIČKOG AUTOBUSKOG PREVOZA NA TERITORIJI OPŠTINE LIPLJAN
2024-2028

**Član 1**

U cilju sprovođenja konsultacija i učešća javnosti, u usvajanju akata iz nadležnosti Opštine, objaviti na Websajt Opštine:

Projekt- Akcion Plan i raspored polazaka linija putničkog autobuskog prevoza na teritoriji Opštine Lipljan 2024-2028.

**Član 2**

Primedbe i sugestije na ovaj Projekt –Akcion Plan mogu se poslati Uprava za javne službe zaštite i spasavanja na email adresu: burim.rrustemi@rks-gov.net naj kasnije do 18.07.2024.

**Član 3**

Ova Odluka stupa na snagu danom usvajanja i biće objavljena na Websajt Opštine.

1Br.345/01-31690
Lipljan,03.07.2024

PREDSEDNIK OPŠTINE
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L- 040- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 të datës 4 qershor 2008, si dhe të nenve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr këtë :

# VENDIM

( për korrje - shirjet **2024**)

**Neni 1**

Obligohet, Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, që të organizojë procesin e fushatës së korrje-shirjeve për vitin 2024 në territorin e Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari, formon komisionin profesional për monitorimin e procesit të korrje-shirjeve për vitin 2024 në territorin e Komunës së Lipjanit.

**Neni 3**

Autokombajnerët duhet të jenë të pajisur me mjetet e nevojshmë gjatë procesit të korrje-shirjeve si mjete kundër zjarrit, rezervuar me ujë, lopatën, kazmën, rërën etj.

**Neni 4**

Autokombajnerët obligohen që të respektojnë rendin e korrje-shirjeve, autokombajnat duhet të jenë në gjendje të mirë teknike, të mos ketë rrjedhje të drithërave më tepër se 5%.

**Neni 5**

Autokombajnerët udhëzohen që të respektojnë rekomandimin e MBPZHR, për lartësinë e çmimit të korrje-shirjes prej 130 € për një hektarë.

**Neni 6**

Mbikqyrjen e këtij vendimi e bënë Drejtorat për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Inspektori i Bujqësisë.

**Neni 7**

Pas përfundimit të fushatës së korrje-shirjeve, Komisioni për monitorimin e procesit të korrje-shirjeve harton raportin e punës lidhur me mbarëvajtjen e procedures së korrje-shirjeve për vitin 2024.

**Neni 8**

Ky vendim hynë në fuqi menjëher dhe me këtë Vendim do të njoftohet Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari si dhe Drejtorati për Inspektorat.

1Nr. 320/01 - 31420
Lipjan, më 02.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, duke u bazuar në Vendimin e komisionit vlerësues për shpalljen e përfituesve për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest and Sports 2024" Nr.5-453/01-32674 të datës 09.07.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

# V E N D I M
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR AKTIVITETET E PROJEKTIT PËR AVANCIMIN DHE AFIRMIMIN E KULTURËS DHE SPORTIT NË KOMUNËN E LIPJANIT

### Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **36,000.00 €** (tridhjetë e gjashtë mijë euro), për t`i mbështetur financiarisht OJQ-në "Vizioni Rinor i Shalës" nga Lipjani për realizimin e aktiviteteve të projektit për avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest and Sports 2024" sipas Projekt- Propozimit të paraqitur sipas Thirrjes publike për aplikim Nr.5-453/01-26243 të datës 28.05.2024.

2. Në tabelën vijuese është OJQ-ja përfituese të cilat do të mbështeten finanaciarisht nga Komuna për projektin avancimin dhe afirmimin e kulturës dhe sportit në Komunën e Lipjanit duke përfshirë organizimin e festivalit "Mërgata Fest and Sports 2024":

| Nr. | Emërtimi i OJQ-së | Shuma |
|---|---|---|
| 1. | OJQ-ja "Vizioni Rinor i Shalës" | 36,000.00 € |
| | Shuma Totale | **36,000.00 €** |

### Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2024 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

### Neni 3

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe OJQ-së do të rregullohen me Kontratë të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe OJQ-së përfituese.

### Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-32674/2
Lipjan, më 15.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 13 të Rregullores për ndarjen subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, nenit 1 të Rregullores 15Nr.011-15426 të datës 17.03.2021 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre, 15Nr.011-71878 të datës 27.11.2018, Vendimit të Kuvendit të Komunës për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit të qytetarëve me vendbanim të përhershëm në territorin e Komunës së Lipjanit 15Nr.400/01-16372 të datës 31.03.2023 si dhe Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023, Kryetari i Komunës nxjerr:

# VENDIM
# PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR SUBVENCIONIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

## Neni 1

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **7,000.00€,** (shtatëmijë e dyqind e tetëdhjetë euro) Bashkësisë Islame dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400/01-12614 e datës 01.03.2024, për subvencionimin e shërbimeve të varrimit për 25 raste të vdekjes, të cilat kanë ndodhur në muajin shkurt të vitit 2024 me nga 280 euro për secilin rast 25 x 280 = 7,000.00€, të cilat shërbime kryhen nëpërmjet BI - dega në Lipjan në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Mirëkuptimit për subvencionimin e shpenzimeve për shërbimet e varrimit e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Këshillit të Bashkësisë Islame dega në Lipjan Nr.1-400/01-23306 e datës 05.05.2023.

## Neni 2

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2024, pozicioni buxhetor - subvencionet e planifikuara për Zyrën e Kryeatrit të Komunës në xhirollogarinë bankare të Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan nr.1719200019037882 në NLB.

## Neni 3

Obligimet e Këshillit të Bashkësisë Islame rreth kryerjes së shërbimeve të varrimit, afatet e raportimit, dokumentacioni dhe çështje tjera që ndërlidhen me obligimet e ndërsjella mes palëve janë të përcaktuara me dispozitat e Marrëveshjes së cekur në nenin 1 të këtij Vendimi.

## Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.

## Neni 5

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Këshilli i Bashkësisë Islame i Kosovës dega në Lipjan.

1Nr.400/01-31121
Lipjan, më 03.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të dates 4 qershor 2008, Rregullores MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Vendimit të Komisionit vlerësues për shpalljen e listës përfituese për OJQ (Klubet Sportive) Nr.05-453/01-29784 të datës 21.06.2024 si dhe Rekomandimit të Kryesuesit të Komisionit vlerësues nr.01-453/01-30892 të datës 28.06.2024, Kryetari i Komunes, nxjerr këtë:

## V E N D I M
## PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR OJQ - TË (KLUBET SPORTIVE) PËR VITIN 2024

### Neni 1

1. Ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej **77,000.00 €** (shtatëdhjetë e shtatë mijë euro), për t\`i mbështetur financiarisht OJQ-të (klubet sportive) të Komunës së Lipjanit për zhvillimin e aktiviteteve të tyre për vitin 2024, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike -Aktivitetet sportive në Komunën e Lipjanit, Nr.5-453/01-18472 të datës 08.04.2024, të shpallur nga Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

2. Në tabelën vijuese janë OJQ-të (klubet sportive) përfituese të cilat do të mbështeten finanaciarisht nga Komuna për vitin 2024:

| Nr. | Emërtimi i OJQ-ve (klubet sportive) | Shuma |
|---|---|---|
| 1. | K.F "ULPIANA 1926" | 10.000.00 € |
| 2. | K.F " ARBËRIA" | 10.000.00 € |
| 3. | K.F "ULPIANA 1992" | 15.000.00 € |
| 4. | K.V "ULPIANA" M | 7.000.00 € |
| 5. | K.V "ULPIANA" F | 5.000.00 € |
| 6. | K.V "SKENDERBEU" | 10.000.00 € |
| 7. | K.SH "CED ELITA " | 1.000.00 € |
| 8. | K.B " LIPJANI" | 1.500.00 € |
| 9. | SH.F "ATLETIKO B" | 1.000.00 € |
| 10. | K.F " VETERANËT" | 1.500.00 € |
| 11. | SH.F " MINATORI" | 1.500.00 € |
| 12. | K.H "ULPIANA" M | 3.000.00 € |
| 13. | SH.P "SPORTIT SHKOLLOR" | 1.500.00 € |
| 14. | K.P "ULPIANA" | 1.000.00 € |
| 15. | K.H "ULPIANA" F | 5.000.00 € |
| 16. | K.P.B.O "PAK BLINAJA" | 1.500.00 € |
| 17. | K.P.P PAK LIPJAN | 1.500.00 € |
| | Shuma Totale | **77,000.00 €** |

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij Vendimi do të paguhet nga kategoria e subvencioneve të planifikuara për vitin 2024 të Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 3**

Të drejtat dhe obligimet në mes të komunës dhe klubeve sportive do të rregullohen në Kontratat të cilat do të lidhen në mes të Kryetarit të Komunës dhe secilit klub veq e veq.

**Neni 4**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

1Nr.453/01-30892
Lipjan, më 01.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 90 të Ligjit Nr. 04/ L-027 për Mbrojte nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera , nenit 8 paragrafi 2, pika 2 dhe nenit 10 të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr. 17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

**VENDIM**
**PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE**

**Neni 1**

Me këtë Vendim, themelohet, Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në Komunën e Lipjanit, në këtë përbërje;

1. Sadri Shamolli - Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim kryesues
2. Shefqet Amerllahu – Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari , anëtar
3. Hazbi Ademi, - Zyra e Kryetarit, anëtar
4. Kushtrim Jashanica – Drejtorati për Infrastrukrurë, anëtar
5.Sazana Demiri Rexhepi - Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim, sekretare.

**Neni 2**

Komisioni nga neni 1 e këtij Vendimi, në pajtim me nenin 9 të Rregullores 17/2015 emërohet për periudhën 4 vjeçare.

**Neni 3**

Detyrat e komisionit janë përcaktuar me dispozitat e nenit 12 të Rregullores (QRK) Nr. 17/2015 si dhe neneve tjera të kësaj Rregulloreje të cilat kanë të bëjnë me detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve komunal për vlerësimin e dëmeve.

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit

1Nr. 020/04-32090
Lipjan, më 05.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

| Pranuar më: / Primljeno: 30.07.2024 | | |
|---|---|---|
| Njësia / Jednica | Numri / Broj | Shtojca / Dodatak |
| 01-130/05- | 36783 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, Ligjit për Zyrtarët Publik Nr NR. 08/L-197, nenit 4 të Rregullores (QRK) - Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijushmërinë e Zyrtarëve Publik si dhe neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.01.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr:

VENDIM
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS PËR SEKTORIN E GJENDJES CIVILE

**Neni 1**

1. Me këtë Vendim përcaktohet zgjatja e orarit të punës për Sektorin e gjendjes Civile i cili funksionon në kuadër të Drejtoratit për Administratë në Komunën e Lipjanit.
2. Sektori i Gjendjes Civile për periodën prej datës 31.07.2024 e deri me datën 30.08.2024, do të punojë çdo ditë pune me palë nga ora 08:00 deri 16:00, duke përfshirë edhe kohën e pauzës prej orës 12:00 deri në 13:00 ku do të punohet me rotacion.

**Neni 2**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Administratë.

**Arsyetim**

Zgjatja e orarit të punës bëhet për shkak të numrit të madh të kërkesave që parashtrohen në këtë Sektor që ndërlidhet me fluksin e ardhjes së mërgimtarëve nga shtetet e ndryshme të botës të cilët e kanë të nevojshme rregullimin e dokumentacionit personal.

Nga të cekurat më lart u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:
Drejtoratit për Administratë
Sektorit të Gjendjes Civile
Sektorit për Personel

1Nr.______________
Lipjan, më ______________

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA LIPLJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

---

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 të Ligjit Nr.2004/18 për tregtinë e brendshme neneve 40 dhe 41 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunes, nxjerr

VENDIM
PËR ZGJATJEN E ORARIT TË PUNËS TË SHËRBIMEVE TË GASTRONOMISË NË QYTETIN E LIPJANIT

**Neni 1**

Me këtë Vendim, përcaktohet zgjatja e orarit të punës për subjektet e biznesit të përkatësisht për shërbimet e gastronomisë të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre brenda territorit të qytetit të Lipjanit deri në ora **24:00** duke filluar nga 17.07.2024 deri me datën 01.09.2024.

**Neni 2**

1.Zgjatja e orarit të punës bëhet për sezonën verore e cila ndërlidhet me fluksin e ardhjes së bashkë atdhetarëve nga diaspora.
2.Zgjatja e orarit të punës të subjekteve të biznesit nuk nënkupton edhe zgjatjen e orarit të punës të punëtorëve më shumë se 8 orë pune në ditë.
3.Subjektet e lartëcekura gjatë kësaj periode obligohen që pas orës 23:00 ta ndalin zërin e muzikës.

**Neni 3**

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe i njëjti do të publikohet në Webfaqen e Komunës.

**Neni 4**

Me kopjen e këtij Vendimi të njoftohen Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtorati për Inspeksion i Komunës së Lipjanit.

1Nr. 330/02-33922
Lipjan, më 16.07.2024

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti